



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mbajtur më 09 mars 2018, (e thirrur në kërkesë të 14 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nr.01-016-/01-0016208/18 të datës 05 mars 2018).

Mbledhja filloi në orën 10;05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishte z.Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

➤ Diskutim për/mbi vërshimet në Komunën e Podujevës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e hap mbledhjen e jashtëzakonshme dhe mbi bazën e nënshkrimeve në listën e pjesëmarrjes konstatoj pjesëmarrjen – kuorumin ku të pranishëm janë të gjithë këshilltarët, mbledhje e cila është thirrur nga subjekti politik LVV, të përkrahur edhe nga këshilltarët e subjekteve politike PDK dhe AAK. Numri i këshilltarëve të nënshkruar që kanë kërkuar këtë seancë janë gjithsejtë katërmëdhjetë. Këshilltarët kanë vlerësuar që të thirret një seancë e tillë mbi bazën ligjore dhe mbledhja është thirrur në bazë të kërkesës. Mund të fillojmë me punë, fillimisht fjalën e ka shefi i Grupit të LVV-së z. Fitim Haziri.

z.Fitim Haziri, theksoi, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni 40, që parasheh seancë të jashtëzakonshme në Grupi i këshilltarëve të LVV-së të mbështetur nga këshilltarët e subjektit PDK- dhe AAK-së duke parë gjendjen e jashtëzakonshme që ka qenë në Komunën e Besianës kemi kërkuar që të thirret kjo seancë e jashtëzakonshme për vërshimet që kanë ndodhur këto ditë. Familje, lagje dhe fshatra të shumta këto ditë pas reshjeve dhe shkrirjes së borës kanë qenë të vërshuar nga uji i lumenjve dhe i përroskave që ka dalë nga shtretërit e tyre. Në shumë raste uji ka depërtuar brenda shtëpive duke iu shkaktuar shumë dëme materiale. Disa nga familjet e prekura nga vërshimet disa ditë me radhë kanë qenë edhe të bllokuara, një nga to është edhe familja e Hakif Fazliut. Ai duke menduar të bëjë një jetë më të mirë kishte ardhur nga fshati Brecë në fshatin Gllamnik për të jetuar në shtëpinë e ndërtuar nga njerëzit e vullnetit të mirë, por ai nuk e gjeti këtë jetë që e ëndërronte, ai sot është edhe më pak i lumtur se sa kur jetonte në fshatin e lindjes Brecë. Hakifi bashkë me gruan dhe tre fëmijët për disa ditë ka mbetur i bllokuar nga uji, raste si ky ka pasur mjaftë këto ditë. Ne e kemi vizituar familjen e Hakifit dhe siç na ka thënë vet ai edhe pse ka kërkuar ndihmë nga Komuna e Besianës Komuna nuk ka bërë asgjë për të. Nëse Komuna nuk ka

pasur mundësi t'ia heq ujin nga oborri, të paktën ka mundur ta ndihmoj me gjëra ushqimore për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike në të cilën gjendet. Veç kësaj uji i kishte bartur edhe drutë dhe nuk kishte me çka të ngrohej. Komuna e Besianës thajse çdo vit ballafaqohet me situata të tilla të vërshimeve, bile dy herë në vit sa herë që ka më shumë të reshura. Është koha që qeverisja lokale të mendoj më shumë, për të gjetur një zgjidhje që të mos kemi situata të tilla. Ne si grup i LVV kërkojmë nga Ekzekutivi që me rishikimin e buxhetit të ndaj një shumë të konsiderueshme të mjeteve dhe të vazhdoj me zgjerimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Llap, sepse ne mendojmë se një prej zgjidhjeve të këtij problemi është jo vetëm zgjerimi por edhe rregullimi i shtratit të lumit me beton dhe gurë, kemi rastin në fshatin Lluzhan që është bërë vetëm zgjerimi dhe anash lumit është vendosur vetëm dhe të cilin këto ditë uji e ka shpërthyer dhe ka dal nga shtrati. Ne e dimë se lumi nuk ka mundësi të rregullohet me beton dhe gurë në tërë rrjedhën e tij por kjo të bëhet sa më parë në pjesën që e përfshinë qytetin, ndërsa në vendet më të ndjeshme ku ka probleme nga vërshimet anash lumit të vendoset material më i fortë e jo dhe i shkriftë. Ne kërkojmë gjithashtu që të formohet një komision me ekspert, përfshirë edhe këshilltarë të kuvendit i cili do të analizojë gjendjen në territorin e Komunës dhe pastaj të jep propozime konkrete se si të gjendet një zgjidhje afatgjate për evitimin e vërshimeve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, mendoj se Drejtori i Drejtorisë përkatëse është më i thirruri për të na informuar lidhur me vërshimet gjatë këtyre ditëve. Fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH z. Faik Muçiqi.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, kam pritur me mirëkuptim kërkesën e grupit të këshilltarëve për një takim të tillë, të jashtëzakonshëm edhe pse ne rregullisht pas këtyre ngjarjeve në seancën e radhës japim informatë, por meqenëse është kërkuar, por dhe nga praktika, sepse është një ide e mirë, qëllim mirë, së pari për tu informuar për gjendjen nga data kryesisht 3 mars 2018 deri ditën e djeshme 08 mars, për të analizuar, hapur çështje, probleme dhe për të rekomanduar se çfarë mund të përmirësojmë në të ardhmen ne si Komunë për këtë problematikë që për fatin e keq është marr jo vetëm Komuna jonë, por edhe komunat tjera dhe regjioni këto ditë. Java e parë e marsit ishte me borë në sasi të madhe ku kaploi tërë territorin dhe pas reshjeve gjithashtu të mëdha të shiut kanë filluar vërshimet dhe ngritja e nivelit të ujit në të gjithë lumenjtë e komunës sonë. Nuk ka ngritje të nivelit të ujit vetëm nga lumenjtë por edhe nga përroskat dhe nga vendet që fare nuk ka pasur përroska e as ujë dhe si rezultat ka shkaktuar përmytje nga sasia e madhe e ujit që e konsideroj se nuk ka qenë kështu me dekada. Këtë e shkaktoi bora dhe shiu brenda një kohe shumë të shkurtër si rezultat i reshjeve të mëdha dhe ndryshimit rapid të temperaturave. Specifike ka qenë edhe nata e datës 6 mars ku tërë natën ishte erë e fortë e cila ka përkeqësuar gjendjen.

Që nga dita e shtunë i gjithë stafi i DSHPMSH, Shërbimi i Zjarrfikësve, Policia, zyrtarë të inspektoriatit dhe zyrtarë të bujqësisë kanë qenë në terren dhe kanë vlerësuar se lumenjtë posaçërisht lumi Dumnica ka pasur sasi të jashtëzakonshme të ujit, lumi Llap për fat të mirë ditët e para ka qenë në nivelin e pranueshëm, ndërsa ditën e diele kemi pasur një rast specifik në rajonin Gërdoc-Batllavë-Bellopojë-Lupç, për arsye se shkarkimet nga Liqeni i Batllavës kanë shkaktuar vërshime të jashtëzakonshme. Do të ndalemi për mënyrën e menaxhimit të Liqenit të Batllavës posaçërisht pas shkarkimeve që kanë ndodhë këto ditë. Banorët e këtij rajoni e kanë vërejtur se ka qenë një sasi e jashtëzakonshme e ujit në këto tri ditë dhe kjo ka rezultuar që fshatrat Lupç dhe Shakovicë të kenë ngritje të jashtëzakonshme, të papërballueshme të ujit krahas lumenjve të tjerë. Furnizimi i ujit të pijes më 4 mars ka qenë i reduktuar për arsye se ujësjellësi ka vlerësuar si të nevojshme reduktimi nga dyshimi i përkeqësimit të cilësisë së ujit por fatmirësisht edhe institutet dhe ujësjellësi kanë njoftuar se uji i pijes nuk ka pasur probleme të tilla dhe furnizimi është

përmirësuar. Menaxhimi i mbeturinave ka qenë normal, kompanitë kanë punuar dhe nuk kanë pasur vështirësi në menaxhimin e tyre, furnizimi me rrymë ditën e shtunë e sidomos të dielën ka pasur problem në qytet për shkak të defektit që ka ndodhur në afërsi të objektit të Komunës kështu që një pjesë e qytetit ka qenë gjatë ditës së diel pa energji elektrike. Shërbimi i Zjarrfikësve ka ngritur numrin e punëtorëve dhe intervenimeve. Meqenëse niveli i ujit ka qenë duke rënë atëherë nuk ka qenë e nevojshme të ngritet gatishmëria më e lartë që të thirret edhe Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim që pasi që kemi strukturë të re politike sigurisht që Kryetari i komunës do të fillojë për ristrukturim të ri të Komitetit. Shkaqet e ndodhjes së vërshimeve dhe atë 2-3 herë në vit janë bukur shumë, janë më komplekse por mund të i përmend disa, si reshjet e mëdha të borës dhe shiut, dëmtimi i shtratit të lumenjve duke filluar nga uzurpimet, ndërtimet e pendave të ndryshme, shkarkimet e ujit nga Liqeni i Batllavës, pastaj hedhja e mbeturinave, dukuri kjo që është duke vazhduar, bartja e druve, pastaj ndërtimet pa planifikime pranë lumit Llap që ndërtojnë dhe investojnë bukur shumë etj. Masat që duhet të ndërmerren, që janë të vazhdueshme në kohë sepse me këtë problematik për fat të keq MMPH fare thuajse nuk ka investuar në Komunën tonë edhe pse menaxhimi i lumenjve bëhet nga Ministria-Departamenti i Ujërave, komuna këto gjashtë vite ka investuar sipas mundësive në zgjerimin e lumenjve dhe se vetëm këtë katër vjeçar që kaluam kemi bërë zgjerimin e lumenjve dhe përroskave atmosferike në gjatësi prej 60 km dhe kjo do të vazhdojë. Këtë vit për zgjerimin e lumenjve kemi planifikuar buxhet prej 280.000 €, apo 12.9 % e buxhetit për investime kapitale që i përket Drejtorisë dhe kemi të ndara 120.000 € për ndërtimin e urave. Në katër vitet e fundit kemi ndërtuar njëzet e tetë ura. Ky është buxhet fillestar, me rishikim mund ta shtojmë këtë buxhet sepse ky është i pamjaftueshëm, sepse zgjerimi i shtratit të lumi Llap nga fshatrat Llugë deri në Pollatë duhet të vazhdojë. Ne si Drejtori jemi në proces të përgatitjes së dosjes së prokurimit për zgjerimin e lumit Llap nga fshati Llugë deri në magjistrale në gjatësi prej 8.5 km, me kosto rreth 100.000 € dhe lumit Dumnica nga dalja, deri në Sfeçël me rreth 6.5 km, janë dy projektet që do të procedohen gjatë muajit mars, ndërsa brenda qytetit, sikurse kemi rastin te lagja “Frashëri” 1.5 km, problemet afër magjistrals, të cilat duhet të trajtohen seriozisht edhe nga ana e drejtorive të tjera si Inspeksioni, Prona, Shërbimet Publike dhe Urbanizmi sepse qyteti duhet trajtuar me kosto më të lartë por edhe me rregullim më të mirë siç është lumi Llap që do të vazhdojë të rregullohet me gurë ashtu siç ka filluar deri në magjistrale. Gjatë kësaj periudhe kemi identifikuar shumë vende, kalesa, rrugë, ura private të materialit të dobët të cilat dalëngadalë duhet ti evitojmë, t’i ndryshojmë për ti bërë ura sipas nevojës që paraqet rasti. Raste specifike kanë qenë 2-3, si te lagja e “Plakollëve” mbi fshatin Letanc që është një problem pasi që ujërat mblidhen aty dhe se kanali atmosferik nuk mund të përcjell sasinë e grumbulluar, nuk e përballon, për fat të keq edhe shtëpitë ndikojnë në vërshimet. Planifikojmë që në këtë vit në një pronë publike ta bëjmë një prerje të një kanali atmosferik në funksion të zgjidhjes së problemit. Rasti i shkollës në fshatin Batllavë, ne vazhdimisht kemi qenë atje dhe për fat të mirë gjendja nuk ka qenë ashtu siç është thënë, edhe pse niveli i ujit ka qenë shumë afër objektit por nuk ka pasur dëme. Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit këtë vit planifikojnë që oborri i shkollës të thuret dhe të bëhet ngritja e mureve dhe definitivisht asnjëherë mos të ketë mundësi të depërtimit të ujit në oborr të shkollës. Gjatë tërë kohës Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, komisioni i ngritur sipas legjislacionit në fuqi me mandat katër vjeçar është në terren dhe shpresoj se në seancën e radhës Komisioni do të arrij të paraqes dëmet e shkaktuara si në bujqësi, infrastrukturë dhe në ekonomi familjare. Deri më tani nga rezultatet vërehet se dëmet më të mëdha janë në infrastrukturë. Drejtori përgjithësisht përmendi dëmtimet në këtë fushë si dhe foli për punët dhe aktivitete që duhet ndërmarrë. Ndër tjera theksoi, një punë që na mbetet ne si Drejtori por që do ta paraqesim edhe në Kuvend është Plani i

Rreziqeve në Komunë, në bazë të të cilit do të na ndihmoni që ato pika të dobëta, të ndjeshme dhe me rrezikshmëri të parashihen në plan dhe ti zbatojmë. Kemi mbajtur kontakte me Agjencinë për Menaxhimin e Rreziqeve por thënë të drejtën ai Agjencion nuk e ka ende rolin e tyre, ndërsa me Qendrat tjera rajonale zakonisht kemi këshilla dhe informacione të rregullta, kemi kontakte, por zyrtarët e Agjencisë nuk e kanë parë të udhës së paku të vijnë dhe të na vizitojnë. Sigurisht që mirëpres edhe propozime konkrete të cilat do të na ndihmojnë me qëllimin më të mirë se ku janë ato pika të dobëta, gjithashtu duhet falënderuar qytetarët që në këtë rast kanë qenë të kuptueshëm dhe të vetëdijshëm për situatën. Ajo që na mbetet si institucion është ngritja e kapaciteteve qoftë në Sektorin për Mbrojtje dhe Shpëtim që ende nuk e kanë atë teren qoftë të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe shpëtimit që ende përballet me problemin e legjislacionit dhe atë herë në kompetencë të Agjencisë e herë në atë të Komunës dhe as i njërit e as i tjetrit dhe në këto raste vetëdijesimi dhe aktivizimi i vet qytetarëve për të mos pritur për ndonjë punë jo të madhe. Nuk ka pasur raste të mbylljes së qytetarëve, ka pas raste ku ka shkuar dhe intervenuar Shërbimi i Zjarrfikësve për të ndihmuar në largimin e përkohshëm dhe kjo është shumë normale. Kemi pasur pak raste që uji ka hyrë brenda podrumëve dhe shtëpive, kjo nuk mohohet dhe që më afërsisht Komisioni do të na sigurojë informacionet e tilla, por të themi që ka qenë një panikë e tillë që kanë mbetur pa u evakuuar, pa buke, pa shkollë etj. raste të tilla nuk ka pasur. Të nderuar Këshilltarë duhet të na ndihmoni në këtë rast, sepse ngjashëm përballen edhe shtetet tjera dhe ne na mbetet që me këto projekte të vazhdojmë, vetëm për vitin e ardhshëm kemi planifikuar 520.000 €, që e përsëris se për zgjerim të lumenjve që do të ndikohet në masë në zvogëlimin e vërshimeve.

Ju falënderoj për vëmendjen, ne do të mundohemi të kemi rekomandimet nga kjo seancë dhe do të shohim se çka mund të përmirësohet, çka është punuar dhe çka jo dhe cilat punë dhe aktivitete duhet të i ndërmarrim në këtë fushë, brenda kompetencave ligjore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, falënderojmë Drejtorin për informatën, ndërsa ftoj shefat e Grupeve të këshilltarëve të marrin fjalën sipas radhës.

z.Avni Fetahu, theksoi, duke u bazuar në informatën lidhur me vërshimet në Komunën e Podujevës, paraqitur nga Drejtori i DSHPMSh, ne si grup i këshilltarëve të LDK-së konsiderojmë se detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorive përkatëse janë kryer brenda kompetencave dhe përgjegjësi që kanë, konsiderojmë se së bashku do të jemi në gjendje të zbusim këtë rrezik në të ardhmen dhe në bashkëpunim ndër-institucional, në vazhdim të investimeve në infrastrukturë, për të vazhduar me zgjerimin e shtretërve të lumenjve. Është me rëndësi të potencohet se investimet e deritanishme dhe planifikimet për investimet në të ardhmen në këtë fushë siç i potencoi edhe Drejtori i shohim si përmirësim të ambientit ku jetojmë në përgjithësi si dhe në minimizimin e dëmeve të mundshme në natyrë që mund të ndodhin në të ardhmen. Ajo çka mund të bëhet në të ardhmen është përmirësimi i sistemeve mbrojtëse dhe të kullimit të tokave në disa lokacione që kryesisht janë të prekura nga vërshimet. Sigurisht që raporti i komisionit për vlerësimin e dëmeve do të paraqet një raport të detajuar dhe nga ato do të adresohen edhe kërkesat në Ministrinë përkatëse për kompensimin e dëmeve siç është bërë edhe më herët. Ajo që u potencua nga Drejtori se Plani i menaxhimit të rrezikut mund të pasurohet edhe me sugjerimet tona që mund t'i japim këtu por edhe me rekomandimet në të ardhmen, pra mund të kemi një plan të menaxhimit të rrezikut edhe në periudha të tjera sepse nuk do të thotë se do të ndodh ngjashëm çdo vit.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kur kemi të bëjmë me raste të tilla siç janë vërshimet apo fatkeqësitë tjera natyrore si ndonjë zjarr apo fatkeqësi tjetër ne kujtojmë se nuk duhet të mendojmë politikisht dhe në baza partiake, andaj se si opozitë përfshirë këshilltarët nga subjektet PDK dhe LVV, mbështetur edhe nga këshilltari i AAK-së e kemi parë të nevojshme të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme lidhur me vërshimet në Komunën tonë e të cilat janë bërë rrezik serioz për

shëndetin, jetën dhe qarkullimin e qytetarëve e po ashtu duke rrezikuar edhe furnizimin me ujë të pijshëm gjatë këtyre ditëve. Ne jemi mjaftë të vetëdijshëm se vërshimet shkaktohen nga të reshurat atmosferike të cilat kanë një fuqi mbinatyrore e të cilat konsiderohen edhe si fatkeqësi natyrore. Edhe pse konsiderohen si fatkeqësi natyrore ne nuk mund të themi se ato ishin të papritura dhe na zunë në befasi. Nuk mund të jenë befasi sepse nga çdo reshje të një intensiteti pak më të lartë vërshimet shkaktohen në vende të njëjta, siç dihet që shtretërit e ngushtë e të paprekur të lumenjve, rrjedhat tjera të ujit dhe përroskat e po ashtu edhe xxxxxx26.25 burim i vërshimeve nga derdhja e ujit të Liqenit të Batllavës. Nga këto vërshime kanë qenë të pakalueshme disa rrugë në fshatin Gërdoc, ku banorët janë prekur dhe kanë mbetur të bllokuar ku së paku tri familje kanë qenë të detyruara të largohen nga shtëpitë e tyre. Të bllokuara kanë qenë edhe familje në fshatin Bellopojë, konkretisht familje në lagjen “Rudari” dhe “Salihu” në masë më të madhe. Po ashtu edhe rruga Ballaban–Orllan është bllokuar tërësisht për shkak të rrëshqitjes së dheut. Edhe shkollën në fshatin Batllavë e ka vërshuar uji, një shkollë e sapondërtuar e cila paraprakisht dihet se është ndërtuar me një ultësi të kufizuar, me moqale dhe është dashur që veprimet e bartjes së ujit dhe parandalimi i ndonjë vështirësie eventuale të merreshin parasysh me kohë sepse vërshimi i njëjtë mund të ndodhë edhe gjatë mbajtjes së mësimit dhe do të rrezikoheshin edhe nxënësit. Nga këto vërshime janë prekur fshatrat Llugë, Batllavë, Gërdoc, Dumosh, Sfeçël, Sallabajë, Llapashticë, Letancë, Lupç, Sibofc, Dumnicë, e disa lagje të qytetit, ndërsa Komuna e Podujevës po atë ditë e kishte lëshuar një deklaratë ku thuhej se edhe përkundër reshjeve të shumta dhe daljes së lumenjve nga rrjedhjet e ujit, nuk ka asnjë lokalitet apo lagje të bllokuar. Kjo komunikatë nuk është reale, e kuptojmë edhe si ndonjë mendim të mirë për ruajtjen e qytetarëve nga ndonjë panik eventual, por sido që të jetë opinionin publik duhet të informohet qartë dhe drejtë. Ne presim nga Ekzekutivi për ndonjë sugjerim apo ndonjë mundësi për t’i ndihmuar familjet të cilat kanë qenë të prekura gjatë këtyre ditëve.

z.Bajram Ajeti, theksoi se shkak i thirrjes ishte ajo se në bazë të informacioneve që na erdhën nga qytetarët por edhe nga aktivist të LVV në terren por edhe nga komunikata që me të drejtë e përmendi parafolësi se komunikata nuk paraqiste gjendjen reale në terren, sepse ne kemi qenë të terren me gjithë asamblistët dhe kemi konstatuar se nuk është paraqitur gjendja reale ashtu siç ka qenë. Sot më shumë u fol për planifikim se çfarë do të bëjmë se sa çka u bë për situatën e cila ishte, jo do të bëhen 280.000 €, e në të vërtetë në komunikatë është 300.000 €, ndërsa ka dallim prej 20,000 €. Mendoj se kjo nuk është qëllimi i kësaj seance, që ne të diskutojmë, është ajo që e tha Drejtori që ne të konstatojmë gjendjen reale ku është bërë mirë, ku është bërë keq, çka është punuar mirë , çka është punuar keq dhe kur mund të përmirësohet në mënyrë që në të ardhmen mos të ndodhë një gjendje e tillë emergjente apo që pasojat e saj të jenë më të vogla se sa janë tani. Ky nuk është një problem që ka lindur në kohë të fundit, kjo është e përhershme. Në terren kemi konstatuar se pasojat e vërshimeve kanë pas edhe rrezikimin e jetës së qytetarëve. Në bazë të këtyre qytetarëve sepse kemi pasur kontakte si dhe kemi bërë fotografi edhe me ta, me familjarë, zonjat e shtëpisë dhe kemi konstatuar një gjendje e cila nuk është paraqitur as në komunikatë por nuk u paraqitë plotësisht as nga Drejtori i DSHPMSh. Janë dëmtuar prona, plantacione të pemëve, serra, kështu që edhe këtu ne kemi dëshmitë me fotografi, p.sh. familja në fshatin Bellopojë dy tre ditë me radhë përpiqet me traktor, me pompa për të shpëtuar plantacionin e mjedrave dhe kjo vërtetë ishte e dhimbshme sepse e shoh si burim të jetës së tyre dhe ekonomi familjare, pastaj rrezikimi i shkollës së re në fshatin Batllavë, këtu do të ndalem më tepër, edhe ju që keni qenë zyrtarë e që keni bërë fotografi te shkolla, unë mendoj se edhe paraqitja sot ishte shumë jo kritike sepse shkolla siç e theksoi edhe parafolësi është ndërtuar në kundërshtim me standardet, është ndërtuar me një lartësi që gjithherë do të ketë rrezikim, shkollë e cila nuk ka mbrojtje nga lumi. Ju

e keni parë vet që muri mbrojtës nga uji ka shkuar deri në atë pjesë që ka lënë mundësinë që lumi të shpërthej dhe të futet në oborr dhe në shkollë. Nëse nuk ka mbrojtje shkolla dhe aty janë me qindra nxënës dhe një ngritje e tillë e ujit a ka mundësi që të rrezikojë jetën e nxënësve. Kjo është papërgjegjësi totale për të ndërtuar diçka jashtë standardeve, aty para shkolle është bërë moçal i cili do të jetë gjatë gjithë viti dhe që do të rrezikoj edhe shëndetin e nxënësve. Tjetër, te ajo shkollë është bërë kanalizimi, gypat e kanalizimit që janë vënë për shkollën janë gjetur edhe në fshatin Gërdoc, a bëhet kanalizimi në sipërfaqe apo të bëhet me standarde ku do t'i qëndroj vërshimit. Janë fotografitë ku i kemi gjetur në fshatin Gërdoc, ja edhe këtu nëpër moçale nëse mund t'i quaj, sepse lumenjtë kanë dalë jashtë rrjedhave por normal që edhe tek kanalizimi nuk janë ndërtuar sipas standardeve, për tu mbrojtur nga vërshimet, nga gjendja e jashtëzakonshme, tjetër kur është fjala te gypat përcjellës të ujit shihni te rruga te Xhamia e vjetër, shikoni çfarë gypash janë dhe a e keni parë gjendjen se si është aty, janë rrezikuar disa familje sepse janë vendosur gypa jashtë standardeve që nuk kanë kapacitet për përcjelljen e ujit, jo këtë vërshim por nuk janë në gjendje të përcjellin një shi normal. Dëmtimi në kafshë, si pasojë kemi edhe ngordhje të lopëve. Familjes Hasani i ka ngordhë lopa, kjo nuk është pak, ne si asamblist duhet të merremi edhe për një individ, atij jo vetëm ushqimi por edhe kanalizimi i është prishur në oborr gjë që posedojmë fotografi për të gjitha këto për t'i dëshmuar. Dëmtimi i pajisjeve elektrike, familjes Krasniqi i është prishur frigoriferi, makina e larjes së enëve, ngrohja qendrore, i është mbushur bodrumi ujë, madje një grua është ankuar se ka pësuar dëmtime në krahatorë, d.m.th. është dëmtimi i teknikës së bardhë, pajisjeve familjare e të tjera nga këto vërshime. Kur shkuam te familja Krasniqi shikoni se çka konstatuam, është bërë një rrugë sigurisht rrugë e fushatave sepse s'mund të jetë tjetër, besoni se nuk është e ngritur as dhjetë cm. mbi tokë, a mund të bëhet një ndërtim i tillë, pa bazë, ajo paraqet rrezik. Unë besoj se familja Krasniqi as nuk do të kishte pasoja në pajisjet e saj familjare por as nuk do të kishte dëshirë që të bllokohet, ajo është e bllokuar. Te çështja e zgjerimit të shtratit të lumenjve, ju mund të thoni se në fushat keni thënë se janë zgjeruar 60 km dhe është pastruar lumi, ndërsa me komunikatën u theksua 45 km, këtë vit 15 km, por kur përmendën fshatin Popovë, lumin e Kaqandollit, Dumnicë e të gjitha këto, unë besoj se ka më shumë km. d.m.th. nuk ka planifikim të qartë, saktë edhe në kohë por edhe në mjete financiare dhe në angazhim se kur kryhen dhe si kryhen, problemi është si janë kryer zgjerimet, sikurse e theksoi edhe kryesuesi i grupit, pastrimi është bërë vetëm sa për sy e faqe, shkon dhe shikon argjenaturat. Kam qenë edhe në fshatin Llugë, mbeturinat prej lumi janë hedhë në skaj të lumit dhe normale është se çdo reshje, çdo vërshim sa do i vogël ai lumë do të shkatërrohet ose do të gërryhet, d.m.th. prap se prap do të paraqet rrezik. Shikojeni fshatin Lluzhan ku ka filluar të gërryjej edhe tokën pjellore, kështu që mendoj se kjo formë e pastrimit të lumenjve të llapit është joprofesionale, jo standarde dhe është vetëm sa për sy e faqe se po bëjmë diçka. Kjo është realitet. Bllokimi i rrjedhës së lumit me mbeturina në fshatin Dumnicë te lagja e "Azemovitëve" shikoni se sa shishe gjenden aty, e që edhe lumit ia iu është ndërruar drejtimin, shikojeni gjendjen në afërsi të Egzonitës si e kemi gjendjen e lumit, mendoj se kjo është hajgare me qytetarët. Prandaj përse ka ardhur deri te kjo që ndërtimet ti kemi jashtë standardeve, shikoni p.sh. rrethimin e shkollës, është diçka jo profesionale, shkel e shko, siç thotë populli palaval, pastaj kanalizimet prap shkel e shko jashtë çdo standardi, pastrimi i lumit bëhet vetëm sa për sy e faqe, rrezikohet toka pjellore, rruga që e përmenda është pa kurrfarë baze dhe ne mendojmë që shkaqe janë, e para nepotizmi, e dyta klientelizmi që keni me kompani të papërgjegjshme, me kompani që nuk kanë kapacitete as profesionale, as të mekanizmit për të kryer punë sipas standardeve, pastaj e kemi edhe korrupsionin. Mora vesh nga vet operatorët ekonomik, kemi pasë ofertë për borën që kishim, për pastrimine rrugëve, njërën e keni pasur 18.000 ndërsa ia keni dhënë atij me 6000 €, pse ato kompani mes veti nuk kanë raporte të mira.

Shikoni me kosto prej 6000 € kush do të kryej pastrimin e gjithë rrugëve të Llapit në sezon të dimrit. këtu është çështje e dallaveve, këtu është arsyeja se pse ne na ndodhin edhe fatkeqësi të tilla. Për t'i menaxhuar mirë krizat unë mendoj të shikohet Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, rregulloret e përcaktuara, posaçërisht rregulloret që t'u dilet në ndihmë qytetarëve dhe ne mirëpresim me padurim lansimin e komisionit që thatë se është në terren, që fare nuk e besoj se është sot në terren duke bërë vlerësimin, pra presim vlerësimin e Komisionit. Edhe një çështje, fjala për Liqenin e Batllavës, shikoni nëse kjo Komunë, kjo Administratë ka diçka për ndihmë të emergjencave, a do të ishte më mirë të thirret KEK-u edhe dhjetë ditë para se të mbushet dhe të lëshohet uji nga Liqeni. Kjo është përgjegjësi e juaja sepse nuk keni komunikuar as me KEK-un as me Agjencionin, që në raste të tilla kur Liqeni grumbullon ujë në atë sasi se si duhet të veprohet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, i nderuri këshilltar duhet të i përmbaheni kohës për diskutim sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të komunës. Kjo vlen për të gjithë ne, ti përmbahemi strikt Rregullores.

znj.Florentë Zejnullahu, theksoi, duke parë gjendjen e jashtëzakonshme, ditëve të fundit për shkak të reshjeve është më se e arsyeshme që kemi marr vendimin për të thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, së bashku për të gjetur zgjidhjen më të mirë për qytetarët tonë. Kërkesat e mia janë këto. Fillimisht kërkoj një aktivizim më të madh prej Inspeksionit të Komunës nëpër fshatra të caktuara përgjatë rrjedhjes së lumit Llap dhe lumenjtë tjerë në mënyrë që të identifikojnë personat e pandërgjegjshëm të cilët hedhin mbeturinat në lumenjtë, e që shkaktojnë bllokim të rrjedhjes së lumit, e në këtë rast gjatë sezonit të shirave, reshjeve të shumta edhe daljen e tij nga shtrati. Kërkesa tjetër e imja është që Komuna në këtë rast të kërkoj fonde shtesë prej Qeverisë së Kosovës për kompensimin e dëmeve qytetarëve të shkaktuara në kulturat bujqësore, ekonomitë familjare etj.

z.Avni Islami, gjendje e jashtëzakonshme, gjendje emergjente, shprehje që i dëgjojmë thuhet çdo ditë. Deri tani vetëm shkarazi pash dhe dëgjova gjendjet e jashtëzakonshme. Të gjithë po flasim në vija të trasha, askush deri më tani nuk foli për gjendjen faktike qoftë nga opozita apo nga Drejtori. Unë si këshilltar i Komunës dëshiroj që sot meqë është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme të marrim informacione se sa familje kanë mbetur pa kulm mbi kokë, sa familje nuk mund të jetojnë në shtëpitë e tyre për shkak të depërtimit të ujit. Unë vetëm një familje arrita ta vizitoj, e cila faktikisht nuk i ka kushtet të jetoj për momentin për shkak të depërtimit të ujit brenda në shtëpi. Mora informacion se përfaqësuesit e Komunës kanë qenë dhe e kanë vizituar atë familje, por le të më tregoj Drejtori se çka është ndërmarrë në atë rast dhe disa të tjera, në mënyrë që kështu të veprohet sa më shpejt sepse nuk mund të presim deri në seancën e radhës të jepet raporti se kaq familje kanë mbetur jashtë shtëpive, që nuk mund të jetojnë në ato kushte dhe nëse nuk ka informacione, Drejtor unë për atë familje mund të jap të jap informacionet, por meqë përfaqësuesit e Komunës kanë qenë atje sigurisht që i kanë. Edhe sa i përket opozitës, në mënyrë vizuale, në vija të trasha mendoj se i dha disa vërejtje që ato do të duhet bërë në një plan afatgjatë. U thirr seancë e jashtëzakonshme, mirëpo unë nuk po shoh diçka të jashtëzakonshme.

z.Arbër Blaku, theksoi, unë kam një kërkesë pak më specifike, është kërkesa prej bizneseve në rrugën “Zahir Pajaziti” konkretisht është për Kryetarin, por pasi që mungon, për Nënkryetarin apo drejtorin, çka ka ndodhur me rrugën “Zahir Pajaziti” ku edhe pas investimit para fushatës prap po ka vërshime, prap po grumbullohet - bartet uji që nga Posta dhe shkon deri te lagja ku unë jetoj, andaj shtroj pyetje, çka ka ndodhur kur e dimë që është bërë një investim para fushatës dhe të gjitha kanalizimet sipas informatave janë rregulluar, çka është bërë me atë kanalizim.

z.Blerim Maçastena, theksoi ditët e kaluara patëm reshje të shiut dhe bora e cila u shkri me shpejtësi shkaktoi vërshime të mëdha në disa fshatra të Llapit. Fshatrat më të prekura nga

vërshimet janë: Surkish, Sfeçël, Dumosh, Gllamnik, Siboc, Llugë, Batllavë, Gërdoc, Bellopojë, Shakovicë, Lupç i Poshtëm dhe disa lagje të qytetit. Siç e dini Komuna jonë vazhdimisht ballafaqohet me probleme të vazhdueshme gjatë reshjeve të shpeshta atmosferike sidomos fshatrat por duke mos anashkaluar qytetin i cili ka probleme të shumta me vërshime. Shkaqet më të shpeshta të vërshimeve janë: bllokimi i lumenjve ose ngushtimi i shtratit të lumit Llap dhe lumit Dumnica, hedhja e materialeve të ngurta, drunj të vjetër dhe shumë gjëra të tjera. Në legjislaturën e kaluar nëse nuk gaboj zotëri Kryesues ju keni qenë përgjegjës për emergjenca dhe siguri, keni marrë një aksion për pastrimin e lumit Dumnica dhe pastrimi ka arritur deri në fshatin Sfeçël, por pikërisht këtë vit aty ka pas vërshime, do të thotë vetëm deri në fshatin Sfeçël është pastruar dhe nuk është pastruar për të vazhduar deri në fshatin Llugë ose deri në fshatin Lluzhan. Hudhja e mbeturinave në lumë, lumenjtë tonë më shumë i përngjajnë deponive të mbeturinave se sa lumenjve. Drejtor, e di që është problematike kjo punë por Komuna ka shërbim të inspeksionit dhe Policisë dhe organe kompetente të cilat është dashur të angazhohen pak më shumë në këtë drejtim. Bllokimi i kanaleve kulluese të ujit që në gjuhën e përditshme i quajmë përroska, do të thotë kjo është problematikë, në qytet po ndërtohet mbi përroska kurse në fshatra fshatarët i lëvrojnë përroskat dhe faktikisht po ka vërshime sa herë që ka reshje të shiut. Është dashur këtu inspektorët të jenë më aktiv. Mungesa e gypave atmosferik, jemi në dijeni se është punuar në rrjet të kanalizimeve, por në gypa atmosferik shumë pak, është dashur që të ketë më shumë rrjet të gypave atmosferik. Planifikimi i dobët i infrastrukturës rrugore, pse e them këtë, në të kaluarën nuk kanë qenë rrugët në asfalt, ka pasur më shumë gypa që e kanë kaluar nga njëra anë në anën tjetër të rrugës, ndërsa tani me shtrimin e asfaltit thuajse ka pak gypa ose fare nuk ka. Më ka rastisur të shoh kompanitë duke punuar në rrugë, dalin banorët dhe e pengojnë vendosjen e gypit duke e detyruar ta vendosin në një vend tjetër, mirëpo ndodhë që edhe aty të tjerët e pengojnë dhe çka ndodhë, nuk e vendosin fare gypin. E kemi një rast në fshatin Sfeçël, rruga që qon deri në fshatin Sekiraç, një shi sado i vogël, uji e vërshon asfaltin dhe kështu bëhet i pakalueshëm. Organet komunale, konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit edhe kësaj radhe nuk janë në nivel të detyrave, neglizhente dhe shumë pasive. Organet kompetente më shumë i grasojnë spektatorëve në një ndeshje futbolli se sa mobilizimit dhe tu dalin në ndihmë qytetarëve. Unë dua të ndaj disa fotografi me ju që janë bërë gjatë ndodhisë së vërshimeve të fundit. Fshati Gërdoc, në tërësi rruga është e mbuluar me ujë, po ashtu dhjetëra hektarë tokë janë të mbuluara me ujë, pastaj këtu kemi fshatin Llugë, familja Çunaku, janë evakuuar nga shtëpitë, pastaj kjo është përballë restorantit t'uaj i nderuar z.Mirsad Kamerolli ku shihet bllokimi i përroskës dhe këtu është efekti i vërshimeve, si dhe fotografia e fundit është, gjatë fushatës zgjedhore gjithëherë jeni krenuar me lumin Llap por realiteti është ky sipas kësaj fotografie, ja si duket pastrimi i lumenjve. Ne kemi parë se vërshime ka edhe në vende më të zhvilluara të Botës, si në Gjermani, Francë Itali, Britani të Madhe etj. por organet kompetente janë jashtëzakonisht të mobilizuara dhe të gatshme për t'u dalur në ndihmë banorëve në çdo kohë. Unë kam disa këshilla dhe sugjerime, sepse vetëm me kritika nuk besoj se i ndihmojmë kësaj çështjeje, dhe atë: 1-pastrimi i shtretërve të lumenjve Dumnica dhe Llap dhe lumit i cili rrjedh nga Liqeni i Batllavës, është dashur ti bëhet një pastrim, një mbikëqyrje më e mirë, e jo vetëm të dërgohet kompania aty dhe mos ta mbikëqyr askush dhe prap të na paraqiten problemet e njëjta, 2-ndalja e menjëhershme e hedhjes së mbeturinave në lum, këtu duhet të aktivizojmë sikurse e theksuam edhe më herët inspektorët, Policinë dhe krahas kësaj të bëjmë një fushatë vetëdijësuese për mbrojtjen e lumenjve, 3-debllokimin dhe pastrimin e kanaleve kulluese-përroskave, kjo është emergjente dhe është dashur që organet komunale të jenë në aksion rreth këtyre dukurive, 4-shtrirja sa më shumë e gypave atmosferik, pra të kemi sa më shumë gypa atmosferik, jo vetëm për ujëra të zeza. Me këto intervenime në të ardhmen sado pak

do të zvogëlohen dëmet nga vërshimet, por besoj se nuk është e mundur të ndalen në tërësi vërshimet, por të paktën mos të ndodh që me një rigë shiu të përmbysten fshatrat. Për fund kam një këshillë, do të ishte mirë që si model të merret Komuna e Fushë Kosovës, ata kanë pasur problem me vërshime dhe me disa intervenime në lumin Sitnica sado pak i kanë zvogëluar.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV kërkojmë që të formohet një komision për vlerësimin e dëmeve dhe katastrofave tjera natyrore dhe kërkojmë që komisioni të jetë në përbërje nga Ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, vërshimet janë problem jo vetëm i Komunës së Podujevës, ne kemi pasur mundësi që përmes mjeteve të informimit t'i shohim edhe në komunat tjera. Fatkeqësisht, duhet të pranojmë, se si shtet nuk kemi ende kapacitete, resurse të mjaftueshme që t'i kryejmë detyrat ashtu siç e parasheh ligji. U cek pak më herët fshati Sfeçël, gjendja në fshatin Sfeçël, në veçanti në tri rrugë, atë "Avdullah Vokrri", "Demokracia" dhe "Mehmet Mehana" ka qenë më e rënduar por fatmirësisht pa dëme të mëdha dhe kjo falë investimeve që janë bërë në vitet 2016, 2017 etj. në zgjerimin e shtratit të lumit i cili kalon nëpër fshatin Sfeçël. Kjo nuk do të thotë se nuk ka nevojë ende për investime, por Drejtori i DSHPMSh e theksoi edhe më herët se në këtë vit është në projekt zgjerimi i lumit i cili kalon nëpër fshatin Sfeçël. Të përpiqemi të jemi real, e di se dikush tenton të politizoj këtë çështje dhe të përfitoj në kuptimin politik, por gjendja momentale në Komunën e Podujevës, fatmirësisht po e them prapë nuk është sikurse disa e paraqitën, e citoj një thënie "E respektoj mendimin ndryshe por nuk do të thotë se pajtohem me të". Lus organet përgjegjëse në këtë rast Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që në vazhdimësi të jetë në kryerjen e detyrave siç ka qenë, si këshilltar i Kuvendit që vij nga fshati Sfeçël i falënderoj organet duke filluar nga Kryetari i Komunës që në kuadër të kompetencave dhe mundësive kanë vepruar me kohë në gjendjen e cila ka qenë jo lehtë për tu përballuar për një Komunë me ato kapacitete dhe mundësi financiare që ka.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, kam një sqarim për këshilltarin z. Blerim Maçastena, në mandatin e kaluar drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ka qenë z.Faik Muçiqi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se një konkluzion Kuvendi apo Ekzekutivi i Komunës duhet ta nxjerr, se a ka pas emergjenca apo jo në ditët që shkuan, sepse situata është duke u normalizua pas ndërprerjes së reshjeve. Mendoj, së paku po flas për veti si këshilltar se këtu për të gjykuar dikë por për t'i dhënë zgjidhje situatës së krijuar, për ti bërë zgjidhje të dëmtuarve. Edhe përmes fotove të paraqitura nga këshilltarët z.Bajram Ajeti dhe z.Blerim Maçastena, por edhe përmes mediave elektronike kemi parë se në lokacione të caktuara ka pas gjendje, mos të themi tmerrësisht të rënd, por me dëme në infrastrukturë po, ekonomi familjare dhe kultura bujqësore. Është një realitet që nuk mund e pohojmë as ta mohojmë në mënyrë të njëanshme politike, qoftë këshilltarët e pushtetit, qoftë Ekzekutivi, qoftë ne të opozitës. Do të dëshiroja që secili këshilltar i cili nuk ka post ekzekutiv por përfaqësues të jetë i drejtpërdrejtë në vlerësim të situatës. Mendoj se, thash edhe më parë se këtu nuk jemi për të gjykuar dikë, por as për të lëvdur politikisht sikurse bëri kolegu nga fshati Sfeçël, për arsye se në mandatin e kaluar kolegu nuk ka qenë këshilltar por ka qenë qytetar i Komunës së Podujevës që vazhdon të jetë edhe sot, vërshimet kanë ndodhur në të njëjtat lokacione, të prekura prej dëmtimeve kanë qenë të njëjtat fshatra dhe vërshimet janë shkaktuar në të njëjtit lumenj. Sa është respektuar prej Ekzekutivit Plani i Rrezikshmërisë, Ekzekutiv që ka qenë në mandatin e kaluar pa riformuluar në një lokacion tjetër a jo, këtë përgjigje mendoj se duhet ta jap Ekzekutivi. A mund ti japim përgjigje situatës së kaluar por edhe të nesërme, në gjendjen momentale mund të themi jo edhe pse është nënkryetari këtu por nuk është kompetent për arsye se nuk është kryetari, për arsye se qeverisja nuk është e kompletuar, absolutisht Drejtorit të Drejtorisë

së Shërbimeve Publike nuk dua ti drejtoj asnjë pyetje, jo për qëllim mbrojtjeje apo akuzimi por për arsye se është një drejtor. Përgjigjen për gjendjen në Komunë e jep Kryetari dhe mendoj se në seanca të jashtëzakonshme prezent duhet të jet Kryetari i Komunës dhe do të jap përgjigjen se pse qeverisja dhe drejtorët nuk janë të kompletuar, e këshilltarët që drejtohen veç e veç secili këshilltar ka përgjegjësinë e vet. Këtu kemi të bëjmë me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sepse ka dëme që janë në kompetencë të drejtorit. Absolutisht pasi që komisioni është krijuar, ne kemi të dhëna të përafërta statistikore sepse saktësisht nuk kemi mundur ta konstatojmë sa kultura bujqësore janë të dëmtuara, mirëpo atë raport tonin do ta krahasojmë me raportin e komisionit të juaj. Kemi edhe problemin e vërshimeve nëpër shkolla, por s'kemi drejtor të Arsimit, që jemi në përfundim të vitit, kemi ushtrues detyre por unë nuk desha për të gjykuar, shembull, unë prita nga z.Bunjamin Ejupi nga fshati Sekiraçë të dal prej situatës dhe të tregoj gjendjen reale në shkollën e vet, në fshatin e vet, për votuesit e vet, jo të mirë, sepse është e vërtetë që në shkollën e Sekiraqës lartësia e ujit në bodrum ka arritur deri në 35 cm, këtë mund ta konstatojmë, madje mund ta pyesim edhe drejtorin teknik i cili është dashur ta shkyç energjinë elektrike, të mbushë kaldanë dhe të zbatet apo të mbathë çizmet, e tëra për të vazhduar mësimin, mirëpo këtë përgjegjësi se si do të veprojmë apo se si do të sanojmë dëmin do të jap drejtori i Drejtorisë së Arsimit. Të gjitha këto përgjigje, pasi që edhe e ka pushtetin, përgjegjësinë do ta jep Ekzekutivi, as këshilltarët nga radhët e subjektit LDK jo. Çka është përgjegjësi e këshilltarëve të subjektit LDK, e që mendoj është që në mënyrë unike këto dëme, pa marrë parasysh se kush është prekur të kompensohen, a jo dhe unë kërkoj që të vihet në votim, ndërsa ne të japim qëndrimet tona politike, a jemi pro apo kundër kompensimit të dëmeve, tjetër, të ndajmë buxhetin për dëmet dhe të kemi buxhetin tonë komunal, nuk mund të ndajmë buxhet milionësh sepse e di buxhetin e komunës, por ne nuk kemi të paraparë buxhet. Subjekti politik LDK udhëheqë që shtatëmbëdhjetë vite me Komunën e Podujevës dhe nuk është paraparë buxhet, nuk është kompensuar asnjë familje për dëmin eventual dhe shumë mirë jam në dijeni se ai që nuk është i prekur nga dëmet nuk e kupton atë se si është i prekur nga dëmet. Në raportin zyrtar thuhet se 45 km është bërë pastrim i lumenjve që do të thotë në gjatësi nga këtu gati deri në qytetin e Ferizajit, 45 km është konstatim zyrtar që e ka publikuar subjekti LDK dhe Ekzekutivi. Pra nëse janë investuar 45 km në pastrimin e shtretërve të lumenjve dhe janë shpenzuar ato mjete financiare që janë publike, për të cilat janë në dijeni mediat, ne dhe drejtoritë kompetente ndërsa vërshimet ndodhin prapë aty, në të njëjtat vende, kush mendon se duhet të marr këtë përgjegjësi, ai që e ka tenderuar, ai që e ka dhënë tenderin, punë kryesi si dhe pranuesi i punës, gjegjësisht komisioni. Ne jemi në dijeni se në drejtori përkatëse ka pas pranim të punëve dhe pagesë të mjeteve pa u kryer puna fare, kemi pasur fatura të paguara në Drejtorinë e Arsimit pa arritur drutë për djegie fare në shkollë, këtë përgjegjësi duhet ta merr dikush. Ne kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme, është vlerësuar e jashtëzakonshme, ka pasur dëme dhe do të nxjerrim një konstatim. A janë të mendimit këshilltarët e subjektit LDK se a ka pasur emergjencë apo jo, sepse këto debate mbesin brenda Kuvendit. Ne do të dalim me një konstatim, nëse ju mendoni se nuk ka pasur situatë emergjente, ne mendojmë se ka pas. Nëse mendoni se nuk ka pasur duhet të dilni këtu dhe para mediave në mënyrë që të gjithë ata të prekur të ju dëgjojnë se nuk ka pasur asgjë në Podujevë, se nuk është dëmtuar askush, asnjë ekonomi familjare, asnjë kulturë bujqësore dhe le të ndodhë çka të dojë me ta. Dikush nga LDK duhet të dalë në foltore të konstatoj se qysh e ka dikush nga juve z.Faik Muçiqin drejtor, të gjitha subjektet dhe qytetarët e kanë drejtor, sepse ky është i emëruar dhe nuk është vetëm drejtor i subjektit LDK, dhe askush nuk mund ta respektoj dikush drejtori e cekur se sa ne që jemi këtu, sepse çdo kërkesë duhet të shkoj në zyrën e drejtorit kompetent, sepse është institucion dhe në këtë seancë të jashtëzakonshme unë mendoj se duhet ti bëjmë zgjidhje situatës e jo për të gjykuar dhe lëvdur

sepse për të gjykuar dhe lëvdur kemi fjalë plotë dhe argumente, mirëpo për situatën e caktuar të vërshimeve dhe atyre dëmeve ky Kuvend me Kryesuesin së bashku çfarë përgjigje donë t'i jap dhe cili është mendimi i secilit grup të subjekteve politike në Kuvend. Le të dal LDK, e cila ka shumicën në Kuvend, e ka shefin e grupit dhe të jap mendimin për problemin që ka ndodhur nga fuqia natyrore, pra çka jemi të mendimit të bëjmë, ky është propozimi im, cili është mendimi i LDK-së, i Grupit të këshilltarëve në Kuvend për situatën që ka ndodhur, për dëmet dhe çfarë propozoni të bëni me ata persona të prekur nga dëmet. Të vazhdojmë me grupet e këshilltarëve sepse përndryshe nëse vazhdoni duke u shtyrë dhe duke gjykuar nuk do të mundemi ta mundim me fjalët e njëri tjetrit, por jam i interesuar për të zhvilluar debat individual pa anime politike sepse nuk e kemi thirrur mbledhjen për qëllime politike, ngase ato kanë qenë publike, dikush është dëmtuar, dikush jo, te dikush sikurse e theksoi kolegu është investuar politikisht pak më mirë e ndokund pak më keq, kështu që nuk duam të hyjmë në ato tema, mirëpo të japim qëndrimin tonë politik dhe kur të marrim vendimin Kryesuesi e mbyll seancën.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, subjekti politik PD dega në Podujevë e ka përcjellë me shqetësim situatën e krijuar nga vërshimet e ndodhura para pak ditësh. Ne kemi vizituar pjesën dërmuese të familjeve të prekura nga ato vërshime që për fat të mirë nuk kanë pësuar përpos disa dëmeve materiale për të cilat janë informuar ekipet kompetente që do të evidentojnë dhe sanojnë sa më shpejt që është e mundur. Vërshimet ndodhin, ndodhin në lokalitete të ndryshme, edhe tek ne. Ne si Parti e Drejtësisë ndajmë shqetësimin me qytetarët, për të ndërmarrë hapat e duhur nga institucionet komunale por më shumë me senzibilizimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për ndarjen e mjeteve për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve kulluese në mënyrë që mos të përsëriten vërshime të tjera.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, ne patëm një përshkrim të gjendjes nga Drejtori i cili besoj se ka ndërmarrë masat në përputhje me mundësitë që ka, shpresoj se ka evidentuar pikat se ku duhet ndërhyrë, edhe pas kontributit edhe nga këshilltarët besoj se do të fillohet me sanimin e këtyre problemeve. Mua më vjen mirë që grupet e këshilltarëve që kanë thirrur këtë seancë fatmirësisht janë pjesë e Qeverisë së Kosovës dhe ky Kuvend duhet të bëjë një kërkesë te Zyra e Kryeministrit, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për të na mbështetur, sepse Komuna është e pamundur të përballoj tërë këtë sfidë të vërshimeve dhe të kompensimit të dëmeve. Edhe për kompensim të dëmeve duhet bërë kërkesë te Qeveria edhe pse deri më tani nuk ka treguar vullnet në asnjë drejtim për të mbështetur rajonin e Llapit, të paktën në fatkeqësi ka detyrim kushtetues.

z.Patriot Rudari, po ndalem pak te lumi Batllava i cili lum vërshon atëherë kur është i mbushur Liqeni. Lumi Batllava ka një sipërfaqe prej 315 km². Lumi ka vërshuar në ato pjesë ku nuk është bërë zgjerimi i shtratit të lumit.

z.Avni Fetahu, desha vetëm një sqarim. Një kompensim për dëmin në fushën e bujqësisë e kam bërë në vitin 2016, atëherë kur Ministri i Ministrisë së Financave në atë kohë pat reduktuar mjaft mjetet në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe nga ai kursim i atyre mjeteve buxhetore jo vetëm Komuna e Podujevës por të gjitha Komunat në Nivel vendi kanë përfituar për dëmet e shkaktuara në bujqësi dhe atë siç e parasheh ligji në 25% të dëmit. Unë pashë dhe dëgjova me vëmendje prezantimet e disa këshilltarëve si dhe me fotografi, është një dallim nga periudha e mëhershme kur fotografitë ishin bardhe e zi ndërsa tani me ngjyra, kështu që e konsideroj se secili nga ne do të ishte mirë të qes në foto edhe oborrin e vet dhe shtëpinë e vet pas reshjeve. Unë jam 37 vjeçar dhe pyeta prindërit dhe më të vjetërit dhe ata nuk mbajnë mend kesi vërshimesh. Konsideroj se edhe sikur në oborre tona apo para shtëpive të kishim fotografuar do të kishim gjetur pamje çfarë pasqyruat këtu. Konsideroj se situata u pasqyrua më shumë se sa që është realisht. U

fatkeqësitë natyrore siç janë erërat e fuqishme ku kemi pas rast të ngordhjes së një numri të madh të bagëtive nga sëmundje gungore, kur Kryeministri i Qeverisë në mandatin e kaluar z.Isa Mustafa ka ndarë një fond të veçantë për këto raste dhe besoj që edhe tani e tutje kemi një mundësi që të mbledhim të dhënat nga terreni, nga fermerët, nga ekonomitë familjare dhe me këtë raport përmbledhës nga të gjithë ne t'i drejtohem ministrive përkatëse dhe besoj se do të bëhet një zgjidhje. Në mandatin e kaluar që e potencoi edhe shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së z.Avni Fetahu, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka ndarë një fond të veçantë për kulturat bujqësore dhe kemi arritur që për dy vite radhazi t'i mbështesim të gjithë fermerët në territorin e Republikës së Kosovës, me pjesëmarrje financiare me përqindje prej 25%. Kërkesa ime është që së bashku të gjithë të punojmë jo të sjellim fotografi, sepse më interesant për të gjithë ne është të jemi në shërbim të qytetarëve se sa të merremi me foto, më mirë do të ishte që të gjithë sa jeni këtu në secilin fshat të punojmë, të veprojmë dhe t'i evitojmë rreziqet. Unë mendoj sinqerisht se ende nuk kemi mundësi që as ju as ne të sjellim sot të dhënat lidhur me dëmet që kanë ndodhur gjatë këtyre ditëve, sepse jeni në dijeni që kulturat bujqësore ende disa janë nën ujë, por së shpejti do ta kemi raportin përfundimtar me vlerësim real të dëmeve që kanë ndodhur në Komunën tonë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, qasja ndaj problemit nuk është korrekt, nuk është parimor, nuk është nga forcat politike këtu që po shihet edhe që dëshmohet me këshilltarin z.Mirsad Kamerollin, i ka shkuar uji deri te shtëpia për t'i rrënuar dhe e gjithë lagja është e mbushur me ujë dhe këtu as një fjalë nuk e thotë se ka pasë vërshime, pra kjo është çasja e jonë. Disa duan t'i dëshmojnë dhe e kanë brengën për qytetarët, pse merren me fotografi dhe atë kolor, do t'i kemi gjithmonë, do ti kemi sepse janë provë që s'paku jo për ju por për qytetarët që të binden se ne do të jemi me hallet e tyre në çdo moment dhe do t'i paraqesim ato halle në Komunë. Është çështje e qasjes, mendoj se ne këtu jemi për qytetarin dhe e kemi mandatin prej tyre dhe mos të bëhemi servil të administratës se sot po dominohet më shumë administrata dhe ata që i pëlqejnë mendimet e administratës, duke ditur që administrata i jep llogari Kuvendit. Pra mendoj se qasja rreth problemit nuk është parimor.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, unë pajtoj me këshilltarin z.Avni Islami që propozoi që për rastet e të prekura dhe dëmtuara nga vërshimet të ndajmë nga një shumë simbolike prej 50 €, unë e shtoj që të jet 100 €, ndërsa për shefin e grupit të këshilltarëve të subjektit LVV, dua të i kujtoj se gjatë kohës së vërshimeve katër ditë kam kaluar vetëm me nga dy orë gjumë, por të paktën servilizmi me emrin e Mirsad Kamerollit nuk kanë të bëjnë, s'kanë asgjë të përbashkët fare. Unë e shoh gjendjen si është por edhe mundësitë çfarë janë sepse i ceku edhe Drejtori. I nderuari këshilltar z.Bajram Ajeti, unë e theksova edhe më herët, shpresojmë që Drejtori do t'i qëndroj identifikimit të problemeve edhe ndërhyrjeve për t'i përmirësuar problemet ku i ka identifikuar, natyrisht edhe me ndihmën e juaj që unë besoj se nuk ka asgjë të keqe këtu, sepse jemi zgjedhur prej qytetarëve dhe duhet t'i paraqesim shqetësimet e qytetarëve. Propozoj që përfshirë z.Rafet Llapashtica dhe z.Patriot Rudari, së bashku me anëtarë të tjerë të këtij Kuvendi, pas përfundimit të këtij debati të formohet një komision dhe të shikojmë mundësitë se a mundemi sot të realizojmë një takim me Kryeministrin dhe me Ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe të kërkojmë mbështetje prej tyre sepse është e pamundur për të trajtuar këtë problem me këtë buxhet që ka Komuna sepse vetëm mund të të kaloj ky vit, të vjen viti tjetër dhe të përballohem me të njëjtat probleme, atëherë fatmirësisht pasi që ju jeni pjesë e Qeverisë, e keni partinë e juaj, është më lehtë për të rënë në kontakt me përgjegjësit e institucionit, prandaj ndihmoni në këtë drejtim.

z.Rafet Llapashtica, unë vetëm desha të potencoj se Ekzekutivi është i pakompletuar dhe është realitet që qeverisja nuk është e kompletuar në muajin e tretë 2018 për arsye për të cilat është në dijeni vetëm Kryetari se pse nuk i emëron Drejtorët. Asnjëherë nuk më kanë bërë përshtypje emrat e Drejtorëve të subjektit LDK për arsye se e ka pushtetin dhe mendon të qeverisë, se a qeverisë

mirë apo keq është çështje dhe përgjegjësi e tij., është realitet që nuk i kemi. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z.Mirsad Kamerolli dha një arsytim që vërshimet janë rezultat i uzurpimit të pronave, hedhjes së mbeturinave në lumenj, nëse e ke dëgjuar fjalimin e drejtorit me vëmendje, prej ndërtimeve pa leje në ultësira rreth lumenjve dhe këtë përgjigje për këto probleme duhet ta marrësh prej Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit, të cilin këtë mandat nuk e kemi, edhe në mandatin e kaluar ka qenë i subjektit LDK, por edhe Drejtori i DSHPMSh që theksova se nuk dua t'i bëj fare pyetje për arsye se e di se si është situata politike. Cili është qëndrimi i Kryetarit të komunës së Podujevës. Për të ndërtuar një objekt pa leje, për të uzurpuar një pronë publike duhet me qenë një Drejtor shumë vendimmarrës i cili firmos për tu mos bërë ajo çështje. Aty duhet emëruar njeri serioz dhe jo servil sikurse e theksove. Për mua një Kryetar i Komunës serioz i cili nuk mund të takohet me përfaqësues të Nivelit qendror është shumë e pakuptimtë. Unë nuk e kam problem me u takuar me secilin, i secilit subjekt qoftë në pushtet qoftë në Nivelin lokal qoftë në atë qendror, shkojmë kur të doni. Për të sqaruar edhe një çështje, nëse Drejtori donë të bëhet serioz dhe real, por edhe nëse nuk donë, afër 200.000 € prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë marrë prej Nivelit qendror. Nëse nuk e konstaton Drejtori, konstato ti, nëse edhe ti nuk mundesh e sjellim dokumentin në Kuvend, me kërkesën e Kryetarit z.Agim Veliu ka qenë, por edhe kur është prezent Kryetari e pyesim, para mediave jemi duke folur, jo fshehtas. Nuk është problemi se Niveli qendror nuk ka investuar në Komunën e Podujevës. Problem tjetër është se aftësia e hartimit të projekteve, e din edhe Drejtori z.Isuf Latifi, me aftësinë e njerëzve kompetent tërhiqen grantet nga Niveli qendror, tërhiqen donatorët e huaj, tërhiqen investimet e partneritetit publiko-privat në Komunën ku qeveris dikush serioz, e aty ka kompetencë ai që është i pari i Komunës, atë nuk mund ta bëjmë unë e ti. Për dalë për të shikuar se pse ka ndodhë ky vërshim dhe për të miratuar një buxhet duhet konstatuar se ky vërshim a është bërë si shkak i uzurpimit, dhe nëse ka pësuar ai që ka punuar jashtëligjshëm nuk kemi nevojë ta kompensojmë si Kuvend për të dëmtuar buxhetin e Komunës. Aty duhet të ketë një Drejtor për të konstatuar, sepse këtë nuk kanë mundur ta bëjnë as ish Drejtori z.Hamdi Jaha, as ish Drejtoresha, asnjë pronë për ta liruar në Komunën e Podujevës dhe as brenda katër vjetëve, për të sjellë një konstatim të pronave të uzurpuara, nuk ka arritur as Drejtori z.Abaz Llugaliu të ma sjellë një regjistër të pronave të Komunës së Podujevës në qytet, ndërsa të fshatrave po që e kam edhe sot. Kemi kërkuar regjistër të pronave publike në Komunën e Podujevës, ndërsa Drejtori e ka lëshuar vetëm një regjistër të pronave nëpër fshatra Breçë, Murgull, me nga shtatë e tetë hektar, e asnjë regjistër të pronave publike në Podujevë, që as ju nuk e keni dhe këtë përgjegjësi dikush do ta marr. Edhe për vërshimet në vendet e njëjta ku është investuar, që u përmendën fotografitë, ato fotografi i kemi sjellë, ne e dimë edhe në fshatin Llapashticë Drejtor, ajo kompani që e ka shtruar, kemi foton ku një njeri shihet mbi gypin fi 120 i cili pastaj bie në baltë, pra vazhdimisht do të ketë probleme, madje edhe tek shtëpinë ku e ke ndërtuar ti. Shkojmë në Qendrën e Zjarrfikësve, marrim Planin emergjent dhe le të dalim te shtëpia e z.Mirsad Kamerollit, ku është “Agnesa”, aty ka qenë një kanal shkarkues i ujërave të qytetit i cili është bllokuar me shtëpinë e të përmendurit që është e ndërtuar mbi të, ne mund të shkojmë prej këtij Kuvendi së bashku me Drejtorin e DSHPMSh, përgjegjësin e Qendrës së zjarrfikësve, te objekti “Agnesa” të shohim se ku është kanali zhbllokues i ujërave dhe si është bllokuar, kjo tregohet edhe me te fotografinë e z. Bajram që e tregonte. Zgjedhjen bëni ju, por të ishte një drejtor serioz i inspeksionit, një drejtor serioz i urbanizmit që bën planifikim për këtë qytet, ajo s’kishte guxuar për të ndodhë sepse problemet mbinjerëzore që vijnë prej natyrës nuk mund t’i ndal askush. E thash nuk jam për të gjykuar askënd çka vjen nga qielli, por çka vjen prej njeriut tendencioz zgjedhje jep njeriut serioz. Këtë problem në këtë seancë mendoj se me kësi lloj konstatimesh mund të vazhdojmë mirëpo defektet i

dimë. Shkojmë dhe i konstatojmë rastet, por Drejtori i Inspeksionit duhet t'i zhbllokoj, për ta zhbllokuar duhet ta rrënoj objektin sepse është pa leje. Mirëpo të sqarohemi, unë prapë se prapë nuk jam për ta bërë atë, mirëpo ky është realiteti. Me dalë z. Mirsad në foltore duke menduar se je më serioz se të gjithë këta këshilltarë, duhet me qenë i kujdesshëm, por përndryshe ne dalim në vendngjarje, marrim edhe Qendrën e Zjarrfikësve, Planin emergjent të qytetit të Podujevës dhe shkojmë e zhbllokojmë kanalin.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, nga këshilltari parafolës z.Rafet Llapashtica është për keqardhje që fatkeqësisht po bëhet një pronë private pjesë e debatit dhe e dëshirave tua politike. Dëgjo, është e turpshme ajo që dëgjova nga ty, sepse kanë qenë pothuajse 50 punëtor dhe e gjithë familja komplet dhe vet jam i rrezikuar prej vërshimeve. Është shumë e vërtetë se vendi ku është e ndërtuar ajo lagje është nën nivelin e lumit Llap dhe ka probleme me reshjet. Nuk janë ato të vërteta, sepse e din ti mirë se ku janë problemet, por je i tillë dhe ke dëshirë të shpifësh. Unë jam plotësisht dakord se jemi mbledhur këtu për të debatuar, por dua të i përgjigjem ashtu siç ai ma ktheu. Ke mbështetjen tonë, të shkojmë të shikojmë se ku mund të gjejmë fonde për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, nëse e ke për hirë të qytetarëve. Për çështje personale ne hyjmë kur të duash, janë organet kompetente të cilat e konstatojnë atë se a është apo jo ashtu si e thua ti.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju lutem, jam tolerant dhe dua që ky kuvend të jetë debatues, të japim kontributin për çka edhe jemi të thirrur dhe ju kërkoj që mos t'i tejkalojmë gjërat të cilat nuk duhet tejkaluar, sepse jemi të vetëdijshëm për situatën, por duhet të sillemi strikt sipas Rregullores për punë të Kuvendit, përndryshe jam i thirrur që në situata të tilla të marr masa konform Rregullores së Kuvendit.

z.Blerim Maqastena, theksoi, me gjithë respektin për drejtorët z.Vezir Januzi dhe z.Avni Fetahu, por si shihet po ju pengojnë fotografitë e paraqitura, a ka mundësi të dimë arsyen, është gjendje faktike, fotografitë nuk janë të shpikura, i kam marrë nga rrjetet sociale edhe banorët i kanë shprehë këto shqetësime. Banorët nuk kanë mundësi që problemet e tyre t'i shfaqin këtu dhe ti shohin mediat. Nëse ju pengojnë aq shumë herave të tjera edhe nuk i ekspozojmë. Sa i përket vërshimeve z. Fetahu, jam 40 vjeçar pak më i vjetër se ti, në vitin 2014 ka pas më shumë vërshime dhe të njëjtat vërshime që kanë ndodhur tash kanë ndodhur edhe në vitet e 80-ta, rregullisht, në fshatin Dumosh prej nga vij, konkretisht po flas për fshatin tim sepse e di që të njëjtat vërshime kanë ndodhur, për fshatrat tjera nuk e di. 200 m afër lumit Dumnica nuk mund të ofrohesh e njëjtë ka qenë edhe në vitet e 80-ta, më kujtohet si fëmijë kur punëtorët shkonin me tren në punë dhe detyroheshin të kthehen pasi që nuk mund ta kalonin, por tash punëtor nuk ka. Kam edhe diçka për z.Hasan Ajetin, e falënderove Kryetarin dhe udhëheqjen komunale për ndihmë në fshatin Sfeçël, pyetja është se a mund të na tregosh se çfarë ndihme është dhënë këto 2-3 ditë gjatë vërshimeve, në fshatin Dumosh nuk ka kurrfarë ndihme, jo që nuk ka tash por asnjëherë pas luftës as më e vogla ndihmë nuk është bërë, edhe pse janë me qindra hektar nën ujë.

z.Agim Behluli, për shkak të pozitës dhe vendbanimit në kuptimin gjeografik ne nuk kemi qenë të prekur nga vërshimet, por aty ku unë punoj ka pas vërshime. Dikush nga këshilltarët propozoi shumë simbolike prej 50 € për t'i mbështetur familjet e prekura dhe të dëmtuara nga vërshimet. Unë e mbështes me 100 € familjen Fazliu në fshatin Gllamnik që e përmendi njëri nga këshilltarët dhe një tjetër familje që u përmend dhe që është shumë e rrezikuar, që është në gjendje më të rëndë, ndërsa Komuna me 50 € apo 100 € nuk ndihmohet. Ju lus të gjithëve të merremi ma me seriozitet me këtë çështje dhe të merremi më shumë me ngritjen e ekonomisë tonë, sepse me ngritjen e ekonomisë besoj se në çdo aspekt do të jemi më në nivel.

z.Bashkim Sylja, kisha pas dëshirë që debati të zhvillohet më në nivel, që të mos shkohet me gjëra personale. Nga fjalimi i Drejtorit nuk i gjeta dy përgjigje, që janë shqetësime të mia, Në lagjen

“Obrazhda” në Gllamnik, jo vetëm këtë vit por pesë vite radhazi lumi Llap del nga shtrati duke shkaktuar dëme, ky ishte shqetësimi i parë dhe tjetri, desha të informohem se në cilën periudhë është planifikuar pastrimi i lumit Llap në atë pjesë, dhe lumi tjetër në pjesën nga fshati Penuhë deri në Gllamnik, Llapashticë, sepse çdo vit ka vërshime dhe dëme.

z.Faik Muçiqi, ju falënderoj gjithëvë për këtë debat dhe mirëkuptim. Ato që i paraqita në fillim qëndrojnë pas të gjithave sepse nuk bëj politikë ditore, as thjesht politikë partiake por kam obligim ndaj qytetarëve. Fati që ne sot jemi falë qytetarëve dhe kemi marrë një vlerësim më shumë se të tjerët edhe si subjekt edhe si individ, në një farë mënyre qytetarët kanë vlerësuar edhe të kaluarën edhe besimin në të ardhmen. Të thuash se nuk është bërë asgjë në këtë aspekt, nuk qëndron sepse është bërë, por se është bërë gjithçka nuk mund të thuhet. Nuk jam asnjëherë që të thuhet që gjithçka është mirë, po të ishte mirë nuk ishim mbledhur sot. Unë në fillim paraqita shkurtimisht punën dhe obligimet. Nuk u ndala se ku qytetarë, Shërbimi i zjarrfikësve dhe zyrtarët kanë vepruar dhe që janë duke vepruar. Rreth komisionit për vlerësimin e dëmeve, njëri nga këshilltarët kërkoi që Kuvendi të formoj komision, Kuvendi nuk formon komision, mundet komisione të tjera përcjellëse, fjala vjen ndihmuese. Ngritja e komisionit dhe funksionimi i tij për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera është i rregulluar me ligj, me Rregulloren përkatëse, është komision që e themelon Kryetari i Komunës, me mandat katër vjeçar. Atë raport të Komisionit do ta keni edhe ju. Ju këshilltarë është mirë të komunikoni me anëtarët e Komisionit për raste konkrete, për të shkuar në familjet që kanë nevojë, sepse ka prej tyre që nuk lajmërohen. Vlerësimet e dëmeve të mëhershme kanë qenë shumë më të mëdha, kanë qenë prej 400,000 € e 500,000 €. Nuk është e vërtetë se aty ku është punuar ka më shumë dëme. Nuk kanë qenë të këtij niveli këto tri-katër vite, por se a duhet të përsosen projektet a duhet vazhduar, unë veç se e theksova. Pyetjen e këshilltarit të subjektit PDK lidhur me vërshimet dhe dëmtimet në lagjen “ Obrazhda”, unë në fillim e ceka që këtë vit fazën e dytë, me mundësitë buxhetore duhet së paku pjesa më e ndjeshme deri te “Kërrtokët”, Kunushec dhe Gllamnik të shtrihet zgjerimi i shtratit, sepse ajo është segmenti ku grumbullohet uji më shumë, pra kemi pas edhe përmytje. Vërshime kemi pas edhe ku s’ka lumenj as përrocka, por është grumbulluar uji. Komisioni zyrtar i ka drejtuar kërkesë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për disa raste më të rënda sociale dhe zyrtarët kompetent të Drejtorisë do të vlerësojnë se çfarë ndihme do u jepet, me gjëra ushqimore apo ndonjë ndihmë tjetër. Se a ka qenë gjendje e jashtëzakonshme apo jo, nuk mohohet, se po të ishte krejt normale nuk do të ishim sot duke debatuar, se a ka qenë krejt zi, jo, sepse kanë bërë përpjekje të gjithë, unë falënderoj të gjithë zyrtarët të cilët deri natën vonë kanë qenë në terren në ato kushte dhe sa ka qenë në mundësinë e tyre kanë bërë dhe vazhdojmë. Çështjen e dëmtimeve në infrastrukturë e merr tërësisht Komuna. Te çështja e kompensimit, nuk është çështje se a duhet të jap këshilltari ndonjë mëditje, nuk kalohet kjo kështu, në këtë mënyrë nuk zgjidhet çështja. Çështja e kompensimit të dëmeve në ekonomi familjare është problematike në tërë Kosovës. Komuna nuk ka të drejtë të formoj fonde, fondet janë qeveritare, ka të drejtë të ketë buxhet lidhur me këto, por për kompensime është pak e ndjeshme, Komisioni përgatit raportin që do të arrij në Kuvend, i drejtohet Kryetarit të Komunës dhe Kryetari e përcjell në Qeveri. Qeveria ka ndarë mjete herë pas herë kryesisht për sektorin e bujqësisë, por për strukturat tjera nuk ka ndarë mjete, as për infrastrukturë as për ekonomi familjare, se a do të ndaj në këtë rast, nuk e di edhe pse ka pas premtime se për vërshime të mëdha do të ndahen me miliona, janë shkuar kërkesat nga Komunitat dhe nuk janë kompensuar, sigurisht që jeni në dijeni. Çfarë mund të bëjë Komuna, tërthorazi, përpos infrastrukturës që është dëmtuar, përmes subvencioneve mund të bëjmë, ta zëmë në sektorin e bujqësisë, fjala vjen po qese një bujk është dëmtuar nga vërshimet dhe nuk është kompensuar nga Qeveria, në kuadër të subvencionimit nga Komuna të ketë përparësi dhe është

fakt se ata kanë pasur përparësi, tërthorazi i bëhet njëfarë kompensimi, nuk është ndoshta i plotë por megjithatë është. Pra mund të kërkojmë që kjo të ngritet, pra fjala vjen nëse është paraparë subvencionimi i 200 përfituesve ta ngritim në 300 ku do të përfshiheshin kryesisht këta që janë të dëmtuar nga vërshimet, pra këtë mund e bëjmë. Si drejtor i DSHPMSh jam i hapur që së bashku me ju për të dal në terren për të parë dhe ku mund të ndikojmë por në fillim paraqita disa synime tona që janë brenda buxhetit, ndërsa me rishikim të buxhetit së bashku do të shohim se ku të investojmë. Në qytet infrastruktura e brendshme e kanalizimeve atmosferike dhe fekale është e vjetërsuar, posaçërisht rruga “Skënderbeu”, në rr. “Zahir Pajaziti” nuk është ndërruar kanalizimi atmosferik në kapacitet të plotë, nuk është bërë përmirësim i plotë sepse planifikohet se kur bëhet rregullimi i Sheshit dhe i Bulevardit për të ndërruar komplet kanalizimin fekal dhe atmosferik. Unë shumëçka shënova dhe ato që janë brenda mundësive tona, do të zbatohen, u mundova të jem sa më korrekt dhe korrekt.

z.Fatmir Rudari, theksoi, më bëri të marr fjalën diskutimi i Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, i cili në një aspekt na akuzoi neve këshilltarëve se pse ne nuk kemi dalë në terren për t’i ndihmuar ata qytetarë që kanë pas nevojë. Në diskutimin tim në fillim u mundova të sqaroj arsyen pse është thirrur kjo mbledhje e jashtëzakonshme dhe për të mos u munduar për t’ia humbur kuptimin dhe devijuar në mënyra të ndryshme sikurse është duke ndodhur ka dy orë. Qëllimi i vetëm është të u ndihmohet atyre qytetarëve të cilët janë të prekur prej këtyre vërshimeve e jo në aspekte tjera edhe askush nuk e mohon se nuk ka bërë asgjë Komuna në këto vërshime, por a ka pas nevojë më tepër, sigurisht se ka pas nevojë, por presim ndonjë zgjidhje të dal prej këtij Kuvendi, pra ne e kemi shfrytëzuar të drejtën tonë që na takon duke thirrur këtë seancë, pra jemi duke diskutuar për të dal prej kësaj gjendjeje në mënyrë që herave të tjera për të na gjetur më të përgatitur

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se vërtetë pati diskutime dhe sugjerime të por edhe vërejtje, por nuk mendoj se u devijua ky debat dhe kjo pikë e rendit të ditës. Mendoj se është një seancë konstruktive.

z.Hasan Ajeti, theksoi, arsyeja pse po bëj këtë replikë është diskutimi i z.Blerim Maqastena dhe z.Fitim Haziri. Unë e përmenda Kryetarin i cili de fakto dhe de jure ka qenë, e kam fjalën për fshatin Sfeçël dhe këtu besoj se nuk ka asgjë të keqe dhe po ashtu fjalimi im i mëhershëm nuk pat asnjë element politik, varet si e ke kuptuar ti, është e drejtë e imja dhe artikulum i qëndrimeve të secilit prej nesh. Unë në veçanti fola për fshatin Sfeçël, por dua të theksoj se edhe në fshatin Dumosh është punuar, por kjo varet nga këndi se si e shihni dhe besoj fuqishëm se me një bashkëpunim më të madh do të arrihen edhe ato objektiva për fshatin Dumosh. Unë sa jam në dijeni juve z. Blerim keni qëndruar më shumë në Prishtinë, keni qenë më aktiv në Prishtinë, e ke pasur detyrë që të jesh në Prishtinë.

z.Blerim Maqastena, theksoi, nuk thash se nuk ka qenë Kryetari por unë e kam parë edhe në Batllavë me këpucë të verës dhe me 01.59.25 këmishë, nuk e mohova atë, por unë desha të dijë se çka ju ka ndihmuar, nëse e llogaritni ndihmë vetëm prezencën e tij atëherë në rregull por ndihma konkrete çka ka qenë në këto vërshime, ky është halli im asgjë tjetër. Në fshatin Dumosh në 18 vitet e kaluara sa i përket vërshimeve asnjë punë më e vogël nuk u krye.

z.Florent Hasani, theksoi, mendoj se Komisioni që do të ngritet duhet të verifikoj edhe zonat me ekstreme ku ka pasur shembje nga të reshurat dhe rrëshqitjet e shpejta të borës dhe aty të ndërtohen rrjeta mbrojtëse me qëllim të parandalohen shembjet dhe bllokimet e panevojshme dhe aksidentet e mundshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konstatoj se qe një seancë ku u debatua, ku pat vërejtje dhe sugjerime, kërkesa dhe propozime të llojllojshme, dëgjuam edhe punët dhe aktivitetet që i ka ndërmarrë Komuna dhe Drejtoritë përkatëse për sanimin dhe tejkalimin e kësaj gjendjeje, e cila them se është në përballim e sipër. Është fat i mirë që nuk kemi pas viktime sepse në këto situata thuajse çdo vit ka pas raste të viktimave. Për dëmet e shkaktuara nga vërshimet, Komisioni qenka në terren dhe duke i evidentuar të gjitha dëmet, Komisioni në nivel të Komunës i ngritur nga Kryetari i Komunës me kohë do i grumbulloj të dhënat për dëmet e shkaktuara në sektorët e cekur dhe kërkesa e paraqitur pothuajse nga të gjithë debutuesit ishte që të bëhet më shumë në aspektin e kompensimit të dëmeve të qytetarëve tonë, si dhe në Nivelin qendror, në departamentet përkatëse të bëhet presion nga Komuna, gjegjësisht Kryetari, në funksion të kompensimit të dëmeve dhe të jemi më këmbëngulës në kompensimin e tyre.

Meqë në kuadër të rendit të ditës nuk pati pika tjera, Kryesues i Kuvendit të Komunës z.Fatmir Gashi, e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0019243/18
Podujevë,
09 mars 2018

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi